REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2287/26 datë: 17.06.2026

Npi – 01/148 datë: 26.06.2026

Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, dhe nenin 40, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; Nenin 4 dhe nenin 5 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal; Dhe në nenin 10, paragrafi 3 dhe nenin 15, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, si dhe Ligjin Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina; Vendimin e Ministrisë Nr. 25/5496/MMPHI, date: 15.08.2025, për pëlqim mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt ZMM-5; Kërkesën e MMPHI Nr.6525-2/25 të datës 07.10.2025 për Rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/291 datë: 25.08.2025 për miratimin e PNMIM për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt ZMM-5; Si dhe nenin 32 dhe 37 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 datë:03.09.2008, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më datë 26.06.2026, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE PËR RAJONIN GJILAN DHE FERIZAJ SIPAS REKOMANDIMIT TË MMPH-SË.

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2026, e mbajtur më: 26.06.2026, unanimisht miratoi Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin Gjilan dhe Ferizaj sipas rekomandimit të MMPH-së.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/139 të datës 25.06.2026.

III

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt ZMM-5). Për zbatimin e këtij Plani, përgjegjës është Autoriteti Komunal i Shtimes.

IV

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi Npi-01/291 datë: 25.08.2025 për miratimin e PNMIM për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt ZMM-5.

V

Ky Vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

VI

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES-OPŠTINA ŠTIMLJE
SHTIME-ŠTIMLJE

v.v.

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi